




Agricultural University of Tirana



REPUBLIKA E SHqipëRIE

MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Nr. 603 Prot

9002347
19. 3. 2015

K O N T R A T Ë

“PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE”

Midis

Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

dhe

Universitetit Bujqësor të Tiranës

KREU I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Kontrate është institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fjalë për shërbimin e mbrojtjes së bimëve.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Kontratë është e mbështetur në:

1. Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligjin Nr. 9362, datë 24.03.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, i ndryshuar;
3. Ligjin Nr. 9908, datë 24.04.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9362, datë 24.03.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”;
4. Marrëveshjen kuadër midis Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Nr.975, datë 15.05.2014;
5. Marrëveshjen e Bashkëpunimit për shërbimin e mbrojtjes së bimëve midis Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, Nr.975/2, date 15.05.2014.

Neni 3

QËLLIMI I KONTRATËS

Kontrata synon të përmbushë të gjithë detyrimet ligjore ndërmjet 2 institucioneve për implementimin e shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe rritjes së roleve dhe funksioneve përmes shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve dhe burimeve të tyre.

Neni 4

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, pranë Fakulteti të Bujqësisë dhe Mjedisit, bazuar në kapacitetet e tij laboratorike, do të kryejë:

- *Monitorimin e parazitëve karantinorë, përcaktimin e statusit të tyre dhe metodat e kontrollit karantinor;*
- *Hartimn teknik e rregulloreve për parazitët objekte karantinore;*
- *Përcaktimin e parazitëve objekte karantinore dhe njoftimin e MBZHRAU-së.*
- *Prognozë – sinjalizimin për të gjitha kulturat bujqësore në shkallë vendi dhe hartimin e masave të kontrollit;*
- *Provat biologjike agronomike të PMB-ve gjatë procedurës për rregjistrimin e tyre;*
- *Do të bëjë hartimin e teknologjive për manaxhimin e integruar të parazitëve kërpudhorë, bakterialë, viralë, nematoda, insekte, barëra të këqija, të bimëve bujqësore mbështetur në aspektet kryesore të biologjisë së këtyre parazitëve;*
- *Do të japë asistencë teknike në vendin e shfaqjes së parazitëve e do të rekomandojë masat përkatëse të kontrollit. Në kuadrin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare në fushën e SHMB-ve, do të bëjë vlerësimin dhe monitorimin në vazhdimësi të parazitëve karantinore të listës A₁ dhe A₂ edhe nëse paraziti nuk është shfaqur akoma;*
- *Do të hartojë manuale praktike për laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar pranë AKU-së si dhe atyre të pikave doganore.*

Neni 5

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve do të diagnostikojë dhe përcaktojë të gjithë parazitët bimorë (insekte, kërpudha, bakterie, viruse e nematoda) me status **objekt karantinor** (nga buxheti i UBT-së).

Neni 6

Analizat fitosanitare për objektet karantinore do të jenë element nga ku **Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanave** kryen çertifikimin e materialit bimor mbjellës (nga buxheti i UBT-së).

Neni 7

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve nëpërmjet laboratorëve respektivë do të bëjë të mundur studimin e bioekologjive të parazitëve të bimëve duke përcaktuar edhe masat e kontrollit të tyre në kuadrin e kontrollit të integruar *(nga buxheti i UBT-së)*.

Neni 8

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve do të bëjë prognozë – sinjalizimit, rekomandimin e masave të kontrollit bazuar në ecuritë biologjike si dhe në përzgjedhjen e metodave dhe teknikave të cilat kanë si bazë implementimin e protokolleve standarte të BE-së *(nga buxheti i UBT-së)*.

Neni 9

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve do të përgatitë dhe shpërndajë prognozën në mënyrë permanente, do të dërgohet zyrtarisht pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave *(nga buxheti i UBT-së)*.

Neni 10

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve gjatë procedurës së regjistrimit të pesticideve do të analizojë të gjitha dosjet e ardhura për regjistrim nga pikëpamja agronomike dhe pas verifikimit, nëpërmjet shkresave zyrtare do të japë rekomandimet në lidhje me secilën dosje sipas.

- a. të dhënave për përdorimin (fusha e përdorimit, mënyra e veprimit ndaj parazitëve);
- b. kushteve specifike agroteknike dhe mjedisore në të cilat mund të përdoret ose jo;
- c. mënyrës së përdorimit dhe dozës së rekomanduar të përdorimit;
- d. numrit të trajtimeve, kohës së trajtimit dhe zgjatjes së efektit mbrojtës;
- e. mundësisë së shfaqjes dhe zhvillimit të rezistencës tek parazitët që përdoret;
- f. efektit në cilësinë dhe rendimentin e kulturave të trajtuara;
- g. fitotoksicitetit për bimët që trajtohen (përfshirë dhe kultivarët e ndryshëm të tyre);
- h. efekteve anësore të pa dëshiruara (tek organizmat e dobishëm dhe ata që nuk janë objekt i luftimit, tek kulturat pasardhëse, etj.), *(nga buxheti i UBT-së)*.

KREU II

Zonat e mbrojtura

Neni 11

Masat Zbatuese

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve do të kryejë punë monitoruese fushore dhe diagnostikuese laboratorike për parazitët objekte karantinore në kulturën e patates në zonën e Divjakës, si kalbëzimi unazor *C. michiganensis* spp. *Sepedonicus* (Ring rot) dhe kalbëzimi ngjyrë kafe *R. solanacearum* (Brown rot), si kushte kryesore për eksportin e patateve, si dhe për kultura të tjera bazuar në kerkesen dhe nevojat e paraqitura nga MBZHRAU për krijimin zonave të mbrojtura nga parazitët objekte karantinore (*nga buxheti i MBZHRAU-së bazuar nga një kontratë financiare*).

Neni 12

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës do të hartojë metodikat laboratorike dhe fushore për zonat dhe kulturat sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj kontrate (*nga buxheti i UBT-së*).

Gjithë dokumentacioni i monitorimit në zonat e mbrojtura, do të mbahet pranë këtij Universiteti, ndërsa raportet e punës do të dorëzohen në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë që mbulojnë zonat përkatëse dhe një kopje në Drejtorinë që mbulon mbrojtjen e bimëve në MBZHRAU.

MBZHRAU, sipas kërkesës, do të ketë akses në dokumentacionin e monitorimit në zonat e mbrojtura.

KREU III

Monitorimi dhe luftimi i parazitëve të veçantë

Neni 13

Masa Përgatitore

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës do të:

- Hartojë metodikat fushore për monitorimin e parazitëve të veçantë (*nga buxheti i UBT-së*).

KREU IV

Monitorimi i parazitëve me rëndësi ekonomike

Neni 14

Masa Përgatitore (Përgatitja e rregulloreve teknike)

Drejtoria që mbulon mbrojtjen e bimëve në MBZHRAU së bashku me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës, do të hartojnë këto rregullore:

- Udhëzues për kontrollin e breshkëzës së Kalifornisë (San José);
- Udhëzues për miratimin e rregullave për masat fitosanitare për prodhimin e patates së pastër nga parazitët karantinore;
- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave fitosanitare për parazitë të veçantë (Zjarri bakterial tek faroret);
- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave fitosanitare për parazitë të veçantë;
- Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar;
- Rregullat e regjistrimit, kriteret e vlerësimit të PMB-ve;
- Rregullat për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e PMB-ve;
- Rregullat për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve;
- Udhëzim për vendosjen e një sistemi detyrues të regjistrimit të importuesve të bimëve dhe produkteve bimore;
- Udhëzim për vendosjen e procedurave të notifikimit të ndalimit të një ngarkese ose të një organizmi të dëmshëm, që paraqet rrezik fitosanitar të mundshëm;
- Udhëzim për vendosjen e pasaportes bimore, e cila përdoret për lëvizjen e bimëve dhe të produkteve bimore;
- Udhëzim për rregullat për klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve;
- Udhëzim për rregullat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri;
(nga buxheti i MBZHRAU- dhe burime të tjera).

Neni 15

Masat zbatuese për materialin shumëzues

1. Të përdoret *repozitori i UBT-së* si burim primar nga merret materiali para-bazë (super elitë) për shumëzim.
2. UBT kryen testimet fitosanitare në çertifikimin e blloqeve themelore, nga i cili rrjedh materiali bazë (elitë), si dhe të blloqeve mëmë, nga i cili rrjedh materiali shumëzues i

çertifikuar dhe që përdoret nga fidanishtet për prodhimin e fidanëve (*nga buxheti i UBT-së*).

KREU V

Të ndryshme

Neni 16

Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve do të kryejë:

1. Përditësimi i protokolleve teknike të kulturave bujqësore, sipas prioriteteve të hartuara nga MBZHRAU.
2. Do të përcaktoj kriteret, procedurat e miratimit dhe vlerësimin e laboratorëve të autorizuar, që miratohen me udhëzim të Ministrit, me propozim të Drejtorisë që mbulon mbrojtjen e bimëve në MBZHRAU.
3. Do të propozoj rregullat dhe praktikatat e mbrojtjes së bimëve si dhe hartimin e Praktikave të Mira të Mbrojtjes së Bimëve dhe të Kritereve të Kontrollit të Integruar.
4. Do të propozoj masat e veçanta për rastet emergjente të përhapjes dhe shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit.
5. Do të jetë drejtues teknik i Laboratoreve të Autorizuara të Kontrollit Zyrtar pranë AKU-së, për pastërtinë fitosanitare (*nga buxheti i UBT-së*)

Neni 17

Trajnime

Drejtoria që mbulon mbrojtjen e bimëve në MBZHRAU, së bashku me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës, do të kryejë në mënyrë periodike:

- a. Trajnime të menaxhuesve të serrave, të pemëve frutore, ullishteve dhe hardhisë për implementimin e skemave të kontrollit të integruar të parazitëve të kulturave bujqësore;
- b. Trajnime të inspektorëve të mbrojtjes së bimëve, inspektorëve të karantines në pikat e kalimit kufitar dhe të gjithë specialistëve të tjerë që mbulojnë problemet e mbrojtjes së bimëve dhe të karantinës në qarqe;
- c. Trajnime të agronomeve të laboratoreve të mbrojtjes së bimëve të AKU-së

- për aftësimin teknik të tyre në kryerjen e analizave laboratorike fitosanitare;
- d. Përgatit metodikat e trajnimit dhe trajnon fermerët, inspektorët dhe specialistët e laboratorëve të mbrojtjes së bimëve.

Trajnimet do të kryhen pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës (*nga buxheti i MBZHRAU-ve*).

Neni 18

Dispozita të Fundit

1. Ndryshimet dhe përmirësimet e kësaj kontrate bëhet me pëlqimin e të dy palëve, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, jo më pak se 6 muaj përpara.
2. Kjo kontratë nënshkruhet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë.


REKTORI



Prof. Dr. Fatos HARIZAJ



MINISTRI



Prof. Dr. Edmond PANARITI



Tiranë, më 17/03/2015